



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 48 Datë 29-05-2025

**PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXËNËSIN RENIS
MANKOLLARI, PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË OLIMPIADËN NDËRKOMBËTARE
TË MATEMATIKËS 2025**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin 115/2024 datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, si dhe urdhërin nr.11 datë 14.01.2025 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2025 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë sipas programeve dhe produkteve”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë mbështetjen financiare për nxënësin Renis Mankollari, për pjesëmarrjen e tij në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës 2025 në vlerën 300,000 lekë. për të përballuar shpenzimet e udhëtimit.
2. Pagesa do të kryhet në momentin e paraqitjes të dokumentave justifikues nga nxënësi Renis Mankollari.
3. Mbështetja financiare, do të përballohet nga fondi rezervë, i planifikuar në buxhetin e vitit 2025, me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET Programi AJ122 Prod. V491AAA 00 04910 05 Art. 6090000 -300,000 lekë (Bashkia)

SHTOHET Programi AH122 Prod. V923AAH 00 09230 05 Art. 6020000 +300,000 lekë (Bashkia)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Pro _____

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 28-05-2025

KRYETAR

Ana Verushi

